**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**
**NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE, KORÇE**

**Nr.________Prot.** **Date 27.01.2021**

Për: ***Shqerine,* “HEST” SHPK *me NIPT L21527009H adresa : Tirane,TIRANE Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr 1, Kati 1.***

Procedura e prokurimit: “**Materiale elektrike””**

Numri i referencës së procedurës/loti : **REF-80536-12-01-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: ***Kjo kontrate ka per qellim realizimin e furnizimit me materiale elektrike .***

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

**1. Shoqeria “FREDI ELECTRONIC”SHPK, NIPT K91803020F me vleren: 7,217,340 (shtate milion e dyqind e shtatembedhjete mije e treqind e dyzet) leke.**

**2. Shoqeria “HEST” SHPK, NIPT L21527009H me vleren: 7,503,128 (shtate milion e peseqind e tre mije e njeqind e njezet e tete) leke.**

**3. Shoqeria “VASKE GAQI” SHPK, NIPT K33729014R me vleren: 7,958,400 (shtate milion e nenteqind e pesedhjet e tete mije e katerqind) leke.**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**1 .Shoqeria “FREDI ELECTRONIC” SHPK, per arsye se:**

1.Operatori ekonomik nuk permbush kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik ku ne dokumentet e tenderit shprehimisht eshte kerkuar: ”Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per origjinalitetin e mallrave. Ne rast se operatori ekonomik nuk eshte prodhues duhet te paraqitet autorizim prodhuesi ose autorizim nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi, me objektin e prokurimit, per mallrat e kerkuara. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij”.

Nga operatori Fredi Electronic shpk eshte paraqitur vetem formular i autorizimit te prodhuesit "Borsan" kabllo elektrik per te tregetuar mallrat e tij ne Shqiperi (dt,29.4.2020). Formulari i autorizimit nuk permban objektin e prokurimit per mallrat e kerkuara nga autoriteti kontraktor.

2.Te dhenat e skedave teknike te paraqitura nga operatori ekonomik nuk perputhen me te dhenat teknike te skedave origjinale. Mosperputhjet e te dhenave teknike ne skedat e paraqitura nga operatori ka konstatohen ne pjesen me te madhe te skedave teknike te llambave.

Po japim vetem nje shembull.

Skeda teknike e llambes HQL LED 4000 lm 30 W/4000K E27 e paraqitur nga operatori ekonomik Fredi Electronic sh.p.k ka ndryshime ne te dhenat teknike krahasuar me skeden origjinale te llambes HQL LED 4000 lm 30 W/4000K E27 "OSRAM". Ndryshimet konsistojne ne faktin se temperatura e ngjyres e cila ne skedat origjinale eshte 4000 K ne skeden e operatorit ekonomik paraqitet e modifikuar ne vleren 6200K.

3. Operatori ekonomik nuk permbush kriteret e vecanta te kualifikimit te dokumenteve te tenderit, kapaciteti teknik ku shprehimisht eshte kerkuar:
**Operatorët ekonomikë duhet te dorezojne:**

a)Skedat teknike per te gjithe produktet e shenuara me poshte, te cilat duhet te perputhen me pershkrimin e bere ne specifikimet teknike. Ne rast se dokumentet jane në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.
b) Operatori duhet te paraqese mostra te materialeve te meposhtme te cilat duhet te jene sipas specifikimeve teknike,
c) per mallrat e kerkuara ne piken b) duhet te jene te shoqeruara me certifikate cilesie dhe origjine.

Nga verifikimi i skedave teknike dhe katalogeve te paraqitur ne tender u konstatua se :

1-Nga operatori eshte paraqitur moster e percjellesit alumin Ǿ16 mm me nje mbulese plastike
Ne kushtet teknike kerkohet percjelles me dy mbulesa plastike

2-Nuk ka moster per llamben CMH 35W G12 ,
Ne vend te saj eshte paraqitur moster me llambe 70W,G12

3-Llamba CMH -T 70W E27 nuk permbush kushtet teknike te kerkuara nga ana jone.
Ka fluksin e drites 5300 lm nga 7300 lm sipas kushteve teknike te kerkuara dhe forma nuk eshte tubolare, por elipsoidale.

4 -Nuk ka moster per automat 4 polare me rryme 63A.
Ne vend te saj eshte paraqitur moster me leshues.

5- Ushqyes per llamba led (ac/DC) adapter
Mostra e paraqitur nuk perputhet me skeden teknike.

Ne skeden teknike jane te dhenat e ushqyesit "OSRAM" ndersa ne moster eshte paraqitur ushqyes "RADIUM" I cili nuk ploteson kriteret teknike te kerkuara nga ne.

Sipas kushteve teknike te kerkuara:
• Rryma e rregullueshme e prodhimit 1.0A-4.2A
• IP 65

Te dhenat teknike te mostres se paraqitur
• Rryma e rregullueshme e prodhimit max 3.8A
• IP 20

Nga shqyrtimi i ofertes ekonomike te kesaj shoqerie per gabime aritmetikore, rezultoi se oferta ishte e rregullt dhe nuk kishte gabime aritmetike.

Nga verifikimi i bere ne Regjistrin elektronik te gjendjes gjyqesore per personat e deklaruar rezultuan te pa denuar.

**2 . Shoqerita “VASKE GAQI” SHPK per arsye se:**

1.Operatori ekonomik nuk ka paraqitur certificate ISO 9001:2015 te kerkuar ne dokumentet e tenderit kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik ku shprehimisht eshte kerkuar: “Operatori ekonomik duhet te jete i certifikuar sipas standarteve ISO pwrkatwsisht duhet tw paraqesw: EN-ISO 9001:2015 mbi “Sistemin e menaxhimit tw cilwsisw osw ekuivalentimin e saj, lwshuar nga institucionet zyrtare tw akredituara”. Certifikatat ISO te paraqitura ne kete procedure prokurimi jane te shoqerive te tjera te cilat nuk jane pjesemarrese ne tender.

2.Operatori ekonomik nuk permbush kriteret e vecanta te kualifikimit te dokumenteve te tenderit, kapaciteti teknik ku shprehimisht eshte kerkuar: ” Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per origjinalitetin e mallrave. Ne rast se operatori ekonomik nuk eshte prodhues duhet te paraqitet autorizim prodhuesi ose autorizim nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi, me objektin e prokurimit, per mallrat e kerkuara. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij”. Nga ana e operatorit ekonomik nuk eshte paraqitur asnje autorizim te prodhuesve apo distributoret e autorizuar nga prodhuesi, me objektin e prokurimit per mallrat e kerkuara.

3.Operatori ekonomik nuk permbush kriteret e vecanta te kualifikimit te dokumenteve te tenderit, kapaciteti teknik ku shprehimisht eshte kerkuar:

Operatorët ekonomikë duhet te dorezojne:
a)Skedat teknike per te gjithe produktet e shenuara me poshte, te cilat duhet te perputhen me pershkrimin e bere ne specifikimet teknike. Ne rast se dokumentet jane në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.
b) Operatori duhet te paraqese mostra te materialeve te meposhtme te cilat duhet te jene sipas specifikimeve teknike,
c) per mallrat e kerkuara ne piken b) duhet te jene te shoqeruara me certifikate cilesie dhe origjine.

Nga vleresimi i ofertes teknike ne lidhje mostrat dhe skedat teknike u konstatua si me poshte:

Ne lidhje me llampen led 30W E27 ne skeden teknike te paraqitur figurojne te dhenat:
Deleq, LED Llambe Tipi SL E27 30W 230V- drite e ftohte 6200K IP 54, Kodi: 13-2760300, Tipi I llambes Sl led E27 30 W 230 V, rrezja e gjere 200$^{o}$, Trup alumini dhe veshje plastike, Mbulese mat, Shkalla e hermetizimit IP 54, Drita e ftohte: 6200k, 2700 lumen, Ra>80, Pf>0.5, Klasa e energjise A+, D:100 mm, L:188 mm.

Ne moster eshte paraqitur llambe LED 30 W E27 3000lm, IP 54 dhe ne te dy rastet nuk jane dhene oret e punes te cilat jane parashikuar ne specifikimet e dhena nga autoriteti kontraktor.

4.Nga ky subjekt eshte paraqitur e njejta moster si operatori ekonomik "HEST" shpk, si per percjellesin alumin Ǿ16 mm dhe ushqyesin "OSRAM";per te cilat eshte e autorizuar vetem operatori HEST shpk. i cili eshte pjesemarres ne te njejten procedure prokurimi.

5.Per llamben LED 15 W E27 operatori ekonomik ka paraqitur skede teknike me te dhena te cilat ndryshojne nga mostra e paraqitur ne tender dhe gjithashtu nuk ploteson kriteret teknike te dhena nga autoriteti kontraktor ne dokumentet e tenderit.

Nga shqyrtimi i ofertes ekonomike te kesaj shoqerie per gabime aritmetikore, rezultoi se oferta ishte e rregullt dhe nuk kishte gabime aritmetike.

Nga verifikimi i bere ne Regjistrin elektronik te gjendjes gjyqesore per personat e deklaruar rezultuan te pa denuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqerine **"HEST" SHPK** se oferta e paraqitur, me cmim total me vlere prej **7,503,128 (shtate milion e peseqind e tre mije e njeqind e njezet e tete) leke pa Tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Ndermarrjes se Sherbimeve Publike,Bashkise Korçë** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të së këtij njoftimi, por jo me vone se 5 dite nga kerkesa per lidhjen e kontrates.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

*Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë* : **19.01.2021**

Ankesa: **Nuk ka**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**
**ILIRJAN DINELLARI**